REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 186, datë 28.12.2017

PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE "ERNST & YOUNG" SH.P.K. (SHKUP-DEGA SHQIPËRI), PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2017, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG JETË" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, të nenit 123, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 "Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese "Ernst & Young" sh.p.k. (Shkup-Dega Shqipëri), për auditimin e pasqyrave financiare, për vitin financiar që mbyllet në 31.12.2017, të shoqërisë së sigurimit "Insig Jetë" sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI